



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2021:165184  
Datë: 11.09.2023  
Numri i dokumentit: 04664986

**E.nr.102/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve V.Ç. – H. dhe V.B., të cilat i përfaqëson av Arian Hetemi nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për shkak të borxhit, me datë 11.09.2023 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.102/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.102/23, të datës 30.01.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e licencimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2021:165185, të datës 14.10.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 31.07.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 4,283.44 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.102/23, më datë 11.09.2023**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**